



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-16334

PROCESVERBAL:

Dëgjim buxhetor:

Buxhetin për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026 me banorët e lokaliteteteve Dubravë, Nikaj, Rekë, Sopinicë

Data: 31.07.2023

Vendi: Shkolla Fillore “Kadri Zeka” Dubravë

Ora: 19:00

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar draft buxhetin për vitin 2024, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë,, organizoi dëgjim buxhetor me banorët e lokaliteteteve Dubravë, Nikaj, Rekë, Sopinicë

Fillimisht takimin e hapi Nënkrjetari i Komunës së Kaçanikut Sabedin Vishi, , i cili njoftoi të pranishmit me planifikimin buxhetor për vitin 2024, dhe njëkohësisht e shpalli të hapur debatin.

Tefik Vishi- kërkoi qe tek varrezat e dëshmorëve të vendoset një mbishkrim për tu bërë identifikimi i varrezave të dëshmorëve.

Menduh Krasniqi- propozoj ndërtimin e fabrikës për pastrimin e ujit në Sepetin. Në bregun mbi Sepetin, të vendosen tri shkronjat UÇK. Në këtë pjesë të rregullohet një ambient për pushues pasi që është një sipërfaqe shumë e përshtatshme. Rregullimi i një rruge në lagjen Imishti deri tek shkolla në Vatë.

Fadil Vishi- Rregullimin e trotuarit nga Lumi Lepenc deri tek varrezat e dëshmorëve, krahas edhe ndriçimin publik dhe trotuari . Trotuari dhe ndriçimi publik nga varrezat e lagjes Imisht deri në drejtim të Sepetinit.

Festim Neziraj- Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në Vatë të Epërme.

Xhemil Hajdari- ndërrimin e një gypi të ujësjellësit, pasi që ka rrjedhje të shumta si dhe shtrirjen me asfalt e disa rrugicave.

Edon Baftiu- Të bëhet ndriçimi publik nga shkolla deri tek lagja Kamish, pasi që kjo rrugë është duke u shfrytëzu nga shumë qytetar si shëtitore si dhe rregullimi i rrugës nga lagjja Kamish deri tek lagjja Qorri e emërtuar Fetije Qorri.

Bujar Baftiu- Propozoj shtruarjen e një pjese të rrugës me asfalt, të pllaka e dëshmorëve në lagjen Zhark.

Florina Vishi- propozoj një park në mes të fshatit Rekë dhe Dubravë, konkretisht tek lagjja Hajdari.

Të gjithë njëzëri kërkuar që uji pijes ishte problem në këtë pjesë, nuk ka mirëmbajtje, ka keqpërdorime të ujit, si dhe mos vendosja e gjithë ujë matësve dhe mos shtrirja e rrjetit në çdo familje.



Procesmbajtësi

Fatlume Guri Selimi